Drejtor
R.H.K

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI I RRETHIT DIBËR**
**VENDIM**
**Nr. 10 dt. 17.08.1998**
Për

**Emrimin e drejtorit të Ndërmarrjes së Ujësjellësit Peshkopi**

Mbështetur në ligjin 7582, datë 13.07.1992 "Për ndërrmarrjet shtetërore", neni nr. 19, pika 2, Këshilli i Rrethit Dibër në mbledhjen e datës 17.08.1998 pranoi dorëheqjen e ish drejtorit të Ujësjellësit Z. Arjan Dungu dhe njëkohësisht miratoi propozimin e kryesisë së Këshillit të Rrethit për të emëruar në këtë detyrë Z. Yrmet Kadiu(inxhinjer).

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit të Rrethit
[illegible]ndërim Shehu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I RRETHIT
DIBËR

Nr 181 CH - 29.10.01



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SH. A. "UJESJELLESI PESHKOPI"**
**KESHILLI MBIKQYRES**

# V E N D I M

**Nr.** *16* **date** *23.10.* **2001**

## "PER LIRIM DHE EMERIM NE DETYRE"

Keshilli Mbykqyres i Sh.A. "Ujesjellesi Peshkopi" i krijuar me Urdherin e Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit nr. 29 date 23.03.1999 ***"Per transformimin e ndermarrjes "Ujesjellesi" Peshkopi ne Shoqeri Anonime "Ujesjellesi Peshkopi"*** dhe ne Urdherin nr. 87 date 12.03.1999 ***"Per emerimin e Keshillit te pare Mbykqyres"***, ndryshuar me Urdherin nr. 125 date 01.04.1999 ***"Per lirim dhe emerim ne detyre"*** dhe Vendimin e Gjykates se Tiranes ***"Per rregjistrimin e personit Juridik"*** me nr. 24079 Akt. date 22.05.2000, i mbledhur me date 23 Tetor 2001, mori ne shqyrtim dhe diskutoi per shkresen "Kerkese per lirim nga detyra" perpiluar sipas Vendimit te tij nr. 15 date 11.10.2001 dhe drejtuar Drejtorise se Administrimit Prones Publike ne M. E. P. P.

Gjate kesaj analize Keshilli Mbikqyres

**V e r e j t i :**

- Nga ***Sh.A. "Ujesjellesi Peshkopi"*** nuk jane plotesuar nevojat me uje te pishem te konsumatoreve te qytetit Peshkopi, krahasuar kjo me mundesite qe ka aktualisht ujesjellesi i ketij qyteti. Mos plotesimi i ketyre nevojave na eshte diktuar krahas ndjekjes qe kemi bere si Keshill Mbikqyres edhe nga ankesat e konsumatoreve si dhe nga Organet e Pushtetit *(Prefektura e Qarkut Diber dhe Bashkia e qytetit Peshkopi)*, organe te cilat na jane shprehur per keto mangesi ne mbledhje e takime pune *(nje takim i tille u realizua me date 17.08.2001 ku ishin te pranishem te tre anetaret te Keshillit Mbikqyres me kryetarin e Bashkise se qytetit Peshkopi)* si dhe nepermjet korespondences se shkembyer me Shoqerine dhe me Keshillin Mbikqyres *(korespondence e cila eshte bere prezente gjate mbledhjeve te Keshillit Mbikqyres)*.

***- Nga Shoqeria** gjate ketij viti (2001) **kemi realizim te aktivitetit kryesor te saj me tregues te ulet** (sipas raportimit dhe me shkrim te drejtorit shoqerise ne analizen e dates 17.08.2001) **ku permendim :***

***1- Nivelin shume te ulet te faturimit te ujit per periudhen analizuese, nivel ky qe eshte ne shifren 23.5 %** (prurja ne depot e qytetit eshte 1431.- mije $m^3$ dhe faturimi 336.- mije $m^3$).*

*2. **Realizimin ne masen 80.6 % te arketimeve** te sasise se **ujit te faturuar** konsumatoreve (permendim ketu shkallen teje te ulet te faturimit, 22.5 %), **ndersa nga popullata 70.5 %.***

*- **Drejtori i Shoqerise refuzon Vendimin nr. 6 date 26.04. 2001 "Per miratimin e kontrates te lidhur me Keshillin Mbikqyres** per administrimin dhe drejtimin e **Shoqerise per vitin 2001", ku eshte caktuar** detyre realizimi ne masen **100 % te arketimit te sasise se ujit te faturuar konsumatoreve** (caktimi i kesaj detyre na eshte kerkuar edhe nga M.E.P.P. si dhe nga M.P.P. – drejtorite respektive te tyre), **por kerkohet miratim i kesaj detyre** ne **kufirin 76.5 %, pra qe ne programim caktohet mosrealizim detyrash.***

*- **Keshilli Mbikqyres me Vendimin nr. 10 date 26.04.2001 drejtorin e Shoqerise e ka palajmeruar me shkrim per largim nga** detyra **me motivacionin :** "Per neglizhence ne permbushjen e detyrave te aktivitetit kryesor te Shoqerise gjate vitit 2000, duke mos plotesuar arketimin e faturave te shitjes se ujit me nje diference prej 30.59 % dhe per mos bllokim ne kohe te punimeve, per rikonstruksionin e rrjetit te ujesjellesit ne qytetin Peshkopi, te kryera gjate muajit Gusht 2000 nga ACTED-i jo sipas kushteve teknike te percaktuara ne legjislacionin e vendit tone".*

*- **Ministri i Puneve Publike me shkresen "Urdher Evadimi" nr. 11599 date 06.09.2000, i ka kerkuar Keshillit Mbikqyres te Shoqerise dhenien e mases "Vrejtje me paralajmerim per largim nga detyra" per drejtorin e shoqerise z. Yrmet Kadiu, kjo per rezultat te dobet te gjendjes financiare, te krijuar si pasoje e mos realizimit te disa treguesve ekonomike-financiar,** konkluzion ky i nxjerre nga kontrolli i ushtruar nga kjo Ministri ne Shoqeri gjate ketij viti.*

Ne perfundim te analizes Keshilli Mbikqyres mbeshtetur ne nenin 19, pika 2 e Statutit te Shoqerise, si dhe ne piken 8/c te Kontrates se lidhur midis Keshillit Mbikqyres dhe Drejtorit Shoqerise ***"Per administrimin dhe drejtimin e shoqerise per vitin kalendarik 2001"**, duke marrur ne konsiderate dhe **miratimin e Ministrit te M.E.P.P miratim i dhene** nepermjet **Drejtorise se Administrimit te Prones Publike ne kete Ministri***

## **V e n d o s i :**

**1. Te liroje nga detyra e drejtorit te Sh. A. *"Ujesjellesi Peshkopi"* z. Yrmet Kadiu .**

**2. Mbeshtetur ne propozimin e Prefektit te Prefektures se Qarkut Diber te emeroje ne detyren e drejtorit te Sh.A. "Ujesjellesi Peshkopi" z. Rrahim Spahiu, per te cilin :**

**- Paga mujore mbetet e ajo e caktuar me Vendimin e Keshillit Mbykqyres nr. 2 date 06.06.2000**

**- Kontrata per drejtimit dhe mireadministrimin e Shoqerise per vitin 2001 mbetet ajo e miratuar me Vendimin e Keshillit Mbikqyres me nr. 6 date 26.04.2001**

3. vendimi ju behet i ditur :

- Drejtorise se Administrimit te Prones Publike dhe Ministrit te E.P.P.
- Drejtorise se U.K. dhe Ministrit te M.P.P.e Turizmit
- Orgeneve drejtuese te Pushtetit Vendor :
  - a- Prefektit te Prefektures se qarkut Diber.
  - b- Kryetarit Te Bashkise se qytetit Peshkopi

4. Vendimi hyn ne fuqi daten e prezantimit te drejtorit ne kolektivin e Sh.A. "Ujesjellesi Peshkopi"

**KRYETAR**

**- Xhelil PACI -**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SH.A "UJESJELLESI PESHKOPI"**
**KESHILLI MBIKQYRES**

# V E N D I M

**Nr.** *39* **date** 25.*09.* **2003**

**P E R**

**"EMERIMIN E DREJTORIT TE SHOQERISE "**

Keshilli Mbykqyres i Sh.A. ***"Ujesjellesi Peshkopi"*** i krijuar me Urdherin e Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit nr. 29 date 23.03.1999 ***"Per transformimin e ndermarrjes "Ujesjellesi" Peshkopi ne Shoqeri Anonime "Ujesjellesi Peshkopi"*** dhe ne Urdherin nr. 87 date 12.03.1999 ***"Per emerimin e Keshillit te pare Mbykqyres"***, *(ndryshuar me Urdherat nr. 125 date 01.04.1999* ***"Per lirim dhe emerim ne detyre"***, *nr. 14 date 08.01.2002* ***"Per ndryshim ne Keshillin mbikqyres"*** *te Ministrit Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe nr. 227 date 16.12.2002* ***"Per nje ndryshim ne Keshillin Mbikqyres"*** *te Ministrit te Ekonomise)* dhe me Vendimin e Gjykates se Tiranes ***"Per rregjistrimin e personit Juridik"*** me nr. 24079 Akt. date 22.05.2000, i mbledhur me date 25.09.2003 mori ne shqyrtim dhe diskutoi rreth propozimit te Prefektit Qarkut Diber per emerimin e drejtorit te SHA *(vend vakant)* dhe ne perfundim mbeshtetur ne piken 2, neni 9 *"Kompetencat e keshillit mbikqyres"* te Statutit Shoqerise,

## Vendosi:

1. Te emeroje ne detyren e drejtorit te SHA *"Ujesjellesit Peshkopi"* z. Halil Trupja.

2. Paga eshte ajo e caktuar per drejtorin paraardhes te shoqerise.

3. Kontrata e lidhur midis keshillit mbikqyres dhe drejtorit per drejtimin e SHA-se per vitin 2003 eshte ajo e lidhur ne fillim te ketij viti, me permiresimin qe vijon :

Pas pikes 3 te kontrates *"Per administrimin dhe drejtimin e shoqerise"* te lidhur me date 20.01.2003 dhe e miratuar me vendim te keshillit mbikqyres nr. 32 date 23.01.2003 shtohet pika 3/1 me kete permbajtje :

*"Drejtori i SHA-se merr persiper te ruaj e permiresoje treguesit ekonomiko - financiar te aktivitetit shoqerise (tregues te evidentuar ne fund te 9-te mujorit 2003) per nje periudhe 6-te mujore. Prishja e kesaj rregullsie e konsideron drejtorin e SHA-se te veteliruar nga detyra".*

4. Vendimi hyn ne fuqi daten e prezenatimit te drejtorit ne kolektivin e punonjesve te SHA-se dhe ju behet i njohur :

- *Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit.*
- *Ministrise se Ekonomise (Drejtorise se Administrimit te Shoqerive te Vogla dhe te Mesme).*
- *Drejtorise se Pergjithshme te Ujesjelles – Kanalizimeve.*
- *Prefektit te Qarkut Diber.*
- *Bashkise Peshkopi.*

**KRYETARI KESHILLIT MBIKQYRES**

**- XHELIL PACI -**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT - UJESJELLESI PESHKOPI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHA " UJESJELLESI PESHKOPI "
*KESHILLI MBIKQYRES*

# V E N D I M

Nr.__6__ Date 29/07/2010

" Mbi largimin nga detyra te Drejtorit Ekzekutiv te Shoqerise "

Keshilli Mbikqyres i SHA UJESJELLES PESHKOPI, krijuar me Vendimin Nr. 1 Date 29/01/2008 te Asamblese se Ortakeve te Sha Ujesjelles Peshkopi dhe me Vendimin e Gjykates se Tiranes " Per rregjistrimin e personit Juridk " me Nr. 24070 Akt. Date 22/05.2000, I mbledhur me date __29__/__07__/ 2010 , mbeshtetur ne Statutin e Shoqerise Anonime , Neni 21 pika 1 ku thuhet " Keshilli Mbikqyres emeron dhe shkarkon Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise , kur per kete bien dakort/votojne pro 5 anetare te tij " , per t'i dhene nje ritem te ri punes ne Ujesjellesin Peshkopi :

## V E N D O S I

1. Te emeroje z. Shkelzen Qoka Drejtor Ekzekutiv te Sha . Ujesjelles Peshkopi
2. Marrdheniet financiare fillojne me date 02 / 08/ 2010.
3. Te kryhen veprimet ne baze te legjislacionit ne fuqi.
4. Vendimi hyn ne fuqi menjehere

Sekretare

Luftime SPAHIU

K/Keshillit Mbikqyres

Selami XHEMBULLA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A. UJESJELLESI PESHKOPI

5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E UJESJELLES Sh. A , DIBER

KESHILLI MBIKQYRES

# VENDIM

Nr. 3, date 30.03.2006

Mbeshtetur ne Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 ''Per Shoqerite Tregtare'', ne ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 ''Per transformimin e Ndermarrjeve Shteterore ne Shoqeri Tregtare'' i ndryshuar, si dhe V.K.M. nr.642, date 11.10.2005, ''Per Keshillat Mbikqyres te Shoqerive Anonime Shteterore'',

Keshilli Mbikqyres i ''Ujesjelles'' Sh.A, Diber, i miratuar me aktin e Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes nr. 183, date 06.03.2006, i mbledhur sot ne daten 20.03.2006, unanimisht vendosi:

***Z. Sabri Laçi,*** emerohet Drejtor i ''Ujesjelles'' Sh.A, Diber. Marredheniet e punes dhe ato financiare ne kete pozicion fillojne ne daten 21.03.2006.

Te kryhen veprimet nga shoqeria konform legjislacionit ne fuqi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**Kryetar i Keshillit Mbikqyres**

**Shemsi Aga**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A. UJESJELLES PESHKOPI
KESHILLI MBIKEQYRES

Nr.prot 04

**VENDIM**

**Nr. 04 date 07.12.2011**

PER
*"Emerimin e Drejtorit Ekzekutiv teNdremarjes se Sh.a.Ujesjellesit Peshkopi*

Keshilli Mbikeqyres i Sh.A. **"Ujesjellesi Peshkopi"** i krijuar me **Proces-Verbalin Ansamblese se Ortakeve te Sh.A. Ujesjellesit Nr.1 date 05/03/2008** i mbledhur me date 07/12/2011 mori ne shqyrtim e diskutoi rreth Projekt-Vendimit te paraqitur nga Kryetari I Keshillit Mbikqyres Z.Selami Xhembulla **"Miratimin e Kerkeses per doreheqe te Drejtorit Ekzekutiv te ndermarjes se Sh.a.ujesjellesit Peshkopi Z.Shkelzen Qoka dhe te Emerimit ne kete Detyre te Z.Bedri Kamberi."** dhe ne perfundim Keshilli Mbikeqyres mbeshtetur ne Statutin e Shoqerise Anonime ne Nenin Nr.21 pika 6:

**Vendosi:**

1. Te miratoje ne menyre unanime Projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari I Keshillit Mbikqyres se sSh.A. Ujesjelles Peshkopi per miratimin e kerkeses per doreheqe nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv te Ndermarjes se sh.a.ujesjellesit **Z.Shkelzen Qoka** dhe Emerimin ne kete detyre te **Z.Bedri Kamberi**

2. Vendimi hyn ne fuqi menjehere.

**KRYETARI I KESHILLIT MBIKEQYRES**
**-Selami XHEMBULLA-**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SH.A. UJESJELLES-KANALIZIME PESHKOPI**
**KESHILLI MBIKQYRES**

*Nr 23 prot* *Peshkopi me 25.12.2014*

*Adresa:Rruga "Ismail Feta" ,Lagjia "Treg" Peshkopi,tel++021822761*

# VENDIM
## Keshillit Mbikqyres sh.a.Ujesjelles-Kanalizime Peshkopi
## Nr. 9 date 25.12.2014

***"Mbi Riemerimin e Drejtori te Pergjithshem te Shoqerise."***

Keshilli Mbikeqyres i Sh.A. **"Ujesjellesi-Kanalizime Peshkopi"** mbeshtetur ne Statutin e Shoqerise Anonime ne Nenin Nr.19 pika g,miratuar me vendim te Ansamblese Aksionereve nr.2 date 09.10.2013: ku ***"Keshilli Mbikeqyres emeron dhe shkarkon Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise" ,ligjin 9901 date 14.04.2008 per "Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", duke pare performance e mire ne administrimin e shoqerise gjate mandatit 3-vjecar te Drejtorit te Shoqerise***

**V e n d o s i:**

1. ***Te rimeroje per nje mandate te dyte Drejtor te Sh.A.Ujesjelles-Kanalizime Peshkopi Z.BEDRI KAMBERI.***
2. ***Te kryhen veprimet nga shoqeria konform legjislacionit ne fuqi.***
3. ***Vendimi hyn ne fuqi menjehere.***

**KRYETARI I KESHILLIT MBIKEQYRES**

**-Sabri LACI-**

**SEKRETARI**
**-Dali CANI-**

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA DIBER

Nr.900/1 Prot. Peshkopi më 27/08/2015

VENDIM

PËR NDRYSHIME NË STATUTIN E SHOQËRISË AKSIONARE "UJSJELLËS KANALIZIME" SH.A. PESHKOPI

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe mbështetur në ligjin Nr. 9901, datë. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në ligj nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" dhe V.K.M-së Nr. 510 datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial"

VENDOSA

1. Ndryshimin e statutit të shoqërisë "ujësjellës-kanalizime" SH.A. si më poshtë:

- Neni 1 ndryshon si më poshtë:

Shoqëria emërtohet SH.A. "Ujësjellës Kanalizime Dibër". Shkurtimi i emërtimit të shoqërisë është "UKD" SH.A. Emërtimi i Shoqërisë mund të shkruhet më shkronja të mëdha ose të vogla.

- Neni 2 ndryshon si më poshtë:

Selia e shoqërisë është në Peshkopi, në lagjen "Treg" në rrugën "Ismail Feta" në Nr. 22/ 95 Pasurie në zonën kadastrale 2932 Peshkopi. Shoqëria mund të ushtroj aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Neni 3 ndryshon si më poshtë:

Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të ushtroj aktivitetin nëpërmjet degëve dhe filialeve në të gjithë Shqipërinë.

- Neni 4 ndryshon si më poshtë:

Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet me vendim të asamblesë së aksionarëve ose dispozitave ligjore.

- Neni 7 ndryshon si më poshtë:

1. Aksionet janë të formës nominativë dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

2. Pronësia mbi aksionet i kalanë Bashkisë Dibër bazuar në ligj nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" dhe V.K.M-së Nr. 510 datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" në vlerën 100% të tyre.

- Neni 13 ndryshon si më poshtë:

Organet e shoqërisë aksionare janë:

1. Asambleja e përgjithshme;

2. Këshilli mbikëqyrës dhe;

3. Administratori.

- Neni 14 ndryshon si më poshtë:

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a) Përcaktimin e politikave tregtare;

b) Ndryshime të statutit;

c) Emërimin e shkarkimin e anëtareve të këshillit mbikëqyrës

d) Emërimin e shkarkimin, likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

e) Miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c " d" të kësaj pike;

f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

g) Shpërndarjen e fitimeve vjetore;

h) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

i) Pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;

j) Ndryshime e të drejtave, qe lidhen me aksionet të llojeve e kategorive të veçanta;

k) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykime ndaj organeve të administrimit;

I) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

l) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;

m) Çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund ti kundretojën pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç

rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në baze të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

- Neni 19 ndryshon si më poshtë:

Këshilli Mbikëqyrës përbehet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e Shoqërisë

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e kërkuar në piken 2 të nenit 145 të Ligjit, duke zbatuar afatin e emërimit, të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës mund të rizgjidhen.

**Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:**

a) Të kontrolloje e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga Administratori;

b) Të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandoje asaj vendime të nevojshme për tu marr, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

c) Të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa here vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

d) Të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

e) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

f) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga Administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

g) Emërimin e shkarkimin administratorëve.

2. Ne rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, këshilli Mbikëqyrës duhet të thërrasë menjëherë asamblenë e përgjithshme, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të prishet ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.

Asambleja e përgjithshme vendosi Shkarkimin e anëtareve të këshillit mbikëqyrëse

1. Sabri Laçi
2. Mensur Shehu
3. Isak Kaçi
4. Çiljeta Zuna
5. Fatos Kica
6. Astrit Doçi

Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës :

1. Ilir RABDISHTI
2. Lorenc CIBAKU
3. Dik SPATA

- Neni 21 ndryshon si më poshtë:

Këshillit Mbikëqyrës është përgjegjës për mbajtjen e librave të posaçëm e procesverbaleve:

1. Të gjithë takimet e Këshillit Mbikëqyrës; dhe

2. Të gjitha mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe komiteteve të tij, përfshirë edhe emrin e Administratorit të pranishëm në mbledhje.

- Neni 22 ndryshon si më poshtë:

Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon ne rast se:

1. Personi pushon se qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës ne baze të dispozitave të Ligjit duke përfshirë parashikimet e pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157, pra kur ai kryen funksione administrimi ne Shoqëri.

2. Personi vuan ose mund të vuaje nga (çrregullime mendore);

3. Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose

4. Ka munguar për me shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtareve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës ne mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkoje nga detyra.

- Neni 23 ndryshon si më poshtë:

1. Administratori ka këto të drejta dhe detyrime:

a) Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;

b) Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) Të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, raportin e ecurisë se veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit mbikëqyrës për miratim, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur me pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;

d) Të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershem për rrethanat, qe kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;

dh) Të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;

e) Të raportojnë përpara këshillit mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rendësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;

e) Të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara ne ligj dhe në statut.

f) Të japë direktiva për vartësve për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;

g) Të miratoje marrjen përsipër të detyrimeve me vlere me të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

gj) Të vendose krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

i) Të kryeje veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Detyrat, qe i cakton ligji këshillit mbikëqyrës, nuk mund t'u delegohen administratorit.

3. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të këtij ligji, administratori duhet të informojnë menjëherë kryetarin e këshillit mbikëqyrës.

4. Mandati i administratorit është 3 - vjeçar.

- Neni 24 ndryshon si më poshtë:

Detyra e administratorit përfundon ne rast se:

1. Personi nuk është me administrator ne baze të dispozitave të Ligjit përfshire shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme ne pajtim me piken 2 të nenit 167, dhe shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 135 të Ligjit;

2. Personi vuan ose mund të vuaje nga çrregullime mendore;

3. Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë:

4. Administratori nuk i sjell progres shoqërisë me politikat e tij, ose

5. Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e Administratoreve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkoje nga detyra.

KRYETARI I ASAMBLES

PËRFAQËSUESI I AKSIONERIT

Kryetari i Bashkisë Dibër

Shukri XHELILI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UJËSJELLËS KANALIZIMË SH.A**

---

**VENDIM**

**Nr.** 121 **Datë** 10 . 05 **.2016**

**"PER EMËRIM NË DETYRË"**

Mbështetur në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

**VENDOSA**

1. **Z. Afrim Mikli** emërohet në detyrën e Administratorit të Shoqëris Ujësjellës Kanalizime sh.a Diber
2. Marrëdhëniet financiare i fillojnë me datë 10 /05/2016
3. Të marr në dorëzim detyrën dhe të gjithë bazën materiale që ka në dispozicion.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet P/Burimeve Njerëzore dhe Përgjegjësi i Financës
5. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

**Kryetari i Asamblese Ujesjellës Kanalizime Sh.A Dibër**

**Shukri XHELILI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA DIBËR

---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UJËSJELLËS KANALIZIMË SH.A DIBËR**

---

**VENDIM**
**Nr.** 117 **Datë** 10.05 **.2016**

**"PER LIRIM NGA DETYRA"**

Mbështetur në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

**VENDOSA**

1. **Z. Bajram Himallari** lirohet nga detyra e Administratorit të Shoqërise Ujësjellës Kanalizime sh.a Diber bazuar në kërkesëne tij per dorëheqje me Nr.60 Prot të datës 04.05.2016
2. Të bëjë dorëzimin e detyrës dhe të gjithë bazës materiale që ka në dispozicion brenda datës 16/05/2016
3. Në bazë të pikës 6, Kreu II të V.K.M nr. 511 datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore" të ndryshuar, **Z. Bajram Himallari** ti jepet një shpërblim për pushimet vjetore të pakryera, për vitin 2016, në masën e pagës përkatëse.
4. Marrëdhëniet financiare t'i shkëputen me datë 26/05/2016
5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet P/Burimeve Njerëzore dhe Përgjegjësi i Financës
6. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

**Kryetari i Asamblese Ujesjellës Kanalizime Sh.A Dibër**

**Shukri XHELILI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A UJESJELLES KANALIZIME
ASAMBLEA AKSIONERE
DIBER

*Adresa: Rruga Ismail Feta " Lagjja " "Treg" Peshkopi, Albania, Tel & Fax +35521822761*

**Nr.77_prot** **Peshkopi me01.08 2016**

# VENDIM

**Nr . 15 Datë 01. 08.2016**

**Bazuar ne Ligjin "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" nr.9901 neni 95 "Mbi emerimin e Drejtorit",ne nenin 19 te "Keshillit Mbikeqyres te drejtat dhe pergjegjesite"ne Statutin e Sh.a Ujesjelles-Kanalizime diber ,ne Kodin e Punes se Republikes se Shqiperise ligji nr.7961,date 12.05.1995.**

**VENDOSI**

**1.Te emeroje Z.Halil Trupja ne pozicion Administrator I Sh.a Ujesjelles-Kanalizime Diber.**

**2.Marredhenjet financiare fillojne me date 02.08.2016**

**3.Me zbatimin e ketij vendimi ngarkohet zyra e P/Burimeve Njerzore dhe Pergjegjesi I Finances.**

**4.Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.**

KRYETARI I ASAMBLESE

Perfaqesuesi I Aksionerit person Juridik

Kryetari I Bashkise Diber

Hatem Fida

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- SH.A. UJËSJELLËS KANALIZIME DIBËR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A UJESJELLES KANALIZIME
ASAMBLEA AKSIONERE
DIBER

*Adresa: Rruga Ismail Feta " Lagjja " "Treg" Peshkopi, Albania, Tel & Fax +35521822761*

**Nr._76_prot** **Peshkopi me_01_._08_2016**

# VENDIM

**Nr . _4_ Datë _01_. _08_.2016**

**Bazuar ne Ligjin "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare|" nr.9901 neni 95 "Per shkarkimin e Administratorit" nenin 19 te "Keshillit Mbikeqyres te drejtat dhe pergjegjesite" ne Statutit e sh.a Ujesjelles-Kanalizime diber dhe ne Ligjin nr7961 date 12.05.2016 "Kodi I Punes se Republikes se Shqiperise".**

## VENDOSI

**1.Te liroj nga detyra Z.Afrim Mikli nga pozicioni I punes Administrator I Sh.a Ujesjelles-Kanalizime Diber me kerkesen e tij.**

**2.Te bej dorezimet brenda 5 diteve conform ligjit.**

**3.Marredhenjet financiare I nderpriten me date_06_._08_.2016**

**4.Me zbatimin e ketij vendimi ngarkohet zyra e P/Burimeve Njerzore dhe Pergjegjesi I Finances.**

**5.Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.**

KRYETARI I ASAMBLESE

Perfaqesuesi I Aksionerit person Juridik

Kryetari I Bashkise Diber

Hatem Fida

REPUBLIKA E SHQIPERISE - SH.A. UJESJELLES KANALIZIME DIBER

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**ASAMBLEJA AKSIONERE**
**SH.A UJESJELLËS KANALIZIME**
**DIBËR**

**Nr. 3 Prot** **Peshkopi më 19/01/2017**

# VENDIM

## "PËR NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIEVE TË PUNËS"

**Nr. 1 Date 19/01/2017**

